

***AKT – THEMELIMI***  
***I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR***  
***"IMPIANT COMPANY" SHPK***

Sot me daten 12/09/2022 (dymijë e njëzet e dy ), unë ortaku themelues :

- ***I Z. Artur Keptiu***, I biri I Përparimit, shtetas shqiptar, i datëlindjes 23 Prill 1971, lindur dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. H10423078S
- Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Pergjegjësi të Kufizuar " IMPIANT COMPANY" SHPK.*

***NENI 1.***  
***EMËRTIMI I SHOQËRISË***

Shoqëria do të quhet " IMPIANT COMPANY" SHPK.

***NENI 2***  
***SELIA E SHOQËRISË***

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Lagjja Nr.14,Rr.Bajram Tusha,me deklaratë legalizimi nr.prot 15847,Shkozët,Durrës

***NENI 3***

***OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË***

Prodhim- montim impiante kondensionimi e aspirimi, izolim termik , punime llamarine te ndryshme ne veprintari industriale dhe civile.Import -eksport te makinerive qe lidhen me kete aktivitet , te lendet se pare, etj. Import eksport te artikujve te ndryshem industriale , ushqimore, bujqesore, blektorale , makineri bujqesore, etj. Transport mallrash per vete dhe per te trete , brenda dhe jashte vendit. Investime ne fusha te ndryshme , etj Kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,e krijuar në bazë të legjistalcionit shqiptar.Shoqëria në ushtrimin e kapacitetit të saj do të marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare,dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj ekonomike.



***NENI 4***  
***KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË***

Kapitali themeltar i shoqërisë " IMPIANT COMPANY" **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

***1. ARTUR KEPTIU zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.***

***NENI 5***  
***KOHËZGJATJA E SHOQËRISË***

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

***NENI 6***  
***ADMINISTRIMI I SHOQËRISË***

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. ARTUR KEPTIU** e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëriturje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

***NENI 7***  
***ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE***

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

***NENI 8***  
***NDARJA E FITIMEVE***



Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit finanziar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË  
" IMPIANT COMPANY" SH.P.K  
ARTUR KEPTIU**

